# DËSHMI ARKIVI

**A-476940**
VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Besian Mustafa mungoi në votimin e deklaratës së Kuvendit për aktgjykimin e Speciales |
| ADRESA | https://albeu.com/kosove/besian-mustafa-mungoi-ne-votimin-e-deklarates-se-kuvendit-per-aktgjykimin-e-speciales/1031330/ |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 16:12:22 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 16:11:43 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | b3351f5d68d34db4eda61e942ec6ddc295e92e7f784bba69ea1f998deca535a4 |
| TEKSTI | 80062419945db340ceafafb9302badc484f9da43289c1e5f07d828ebbd47832c |
| PAMJA | f028b3d1acaa72039a6e9101a99d67e81a3e51fdb72cf325d2804b275900d5a8 |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | c5c71ea2d73b6e94ddf23456df3463b987b34bfef13ec9ee2b3eb2baf6cd1f1c |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | 2a9c3c61cd0a94fc8d628189ad3d77be9fe8dbec0733dde85be2277fcecb101e |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c5c71ea2d73b6e94ddf23456df3463b987b34bfef13ec9ee2b3eb2baf6cd1f1c

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Besian Mustafa mungoi në votimin e deklaratës së Kuvendit për aktgjykimin e Speciales




Kuvendi i Kosovës miratoi deklaratën për aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, me 99 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Besian Mustafa, djali i veprimtarit të LDK-së, Xhemajl Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë në çastin kur u votua deklarata.

Sipas informatave të siguruara nga KosovaNews, Mustafa kishte marrë pjesë në seancë, por u largua nga salla para zhvillimit të votimit.

Dokumenti i miratuar nga Kuvendi përbëhet nga shtatë pika.

Me pikën e parë, Kuvendi shpreh shqetësim të thellë për aktgjykimin e shkallës së parë të dhënë ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

Pika e dytë e deklaratës e cilëson si të papranueshëm konstatimin për ekzistencën e një qëllimi të përbashkët kriminal.

Në pikën e tretë, institucioneve shtetërore u kërkohet të ndërmarrin masat e nevojshme për ruajtjen e së vërtetës dhe pastërtisë së luftës çlirimtare të popullit të Kosovës. Gjithashtu, kërkohet hartimi i një strategjie të përbashkët shtetërore për koordinimin e veprimeve juridike, institucionale dhe diplomatike.

Pika e katërt nënvizon se ekzistenca e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale për dëbimin e shqiptarëve nga Kosova gjatë viteve 1998–1999 është dëshmuar përmes aktgjykimeve të Tribunalit Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë ndaj drejtuesve politikë, ushtarakë dhe policorë të Jugosllavisë dhe Serbisë.

Përmes pikës së pestë, Dhomave të Specializuara u kërkohet që mandatin e tyre ta ushtrojnë në përputhje me

të fundit/


A do të pësojë ndryshime ligji për Gjykatën Speciale?


VV-ja merr drejtimin e tetë komisioneve parlamentare


Tuchel shpjegon si zemërimi e ndihmon Bellinghamin të japë…


Gjyqi në Kumanovë, Trajko Bojkovski pranon tri prej katër…


Emilija Rexhepi merr pjesë në Tiranë në konferencën për…


Zubin Potok, zbardhen detajet e masakrës ndaj 23 shqiptarëve dhe…


Flakët përhapen në një zonë me dushqe në Mat, zjarrfikësit në…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

vullnetin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në pikën e gjashtë, Kuvendi kundërshton çdo përpjekje për ta përmbysur atë që e quan të vërtetën historike të Kosovës, për ta vënë në pikëpyetje luftën çlirimtare ose për ta barazuar popullin që luftoi për liri dhe mbijetesë me regjimin që e shtypi atë.

Pika e fundit thekson se e vërteta e luftës çlirimtare, drejtësia për viktimat dhe familjet e tyre, si dhe e drejta e të dënuarve për një gjykim të drejtë, i përkasin së njëjtës Republikë. Në deklaratë thuhet se Kuvendi do t'i mbrojë të tria.

Miratimi i deklaratës u bë me 99 vota për, ndërsa nuk pati asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim.

Shtuar më 28.09.2026 18:11

Tags: besian mustafa , salle , votim



A do të pësojë ndryshime ligji për Gjykatën Speciale?



VV-ja merr drejtimin e tetë komisioneve parlamentare



Emilija Rexhepi merr pjesë në Tiranë në konferencën për zgjerimin e BE-së



Zubin Potok, zbardhen detajet e masakrës ndaj 23 shqiptarëve dhe emrat e t…



Enver Hoxhaj merr drejtimin e Komisionit Parlamentar për Arsim



Dosja e "Grupit të intelektualëve": nëntë të dyshuar për vrasjen dhe…



Përparim Rama pas deklaratës për aktgjykimin e Speciales: Kosova u…




Kërkohet paraburgimi për 9 të dyshuarit për masakrën e 23 civilëve në Zubin-…

© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

**Kategori**
Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

**Linqet**
Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

**Tags**
Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

**Moti**
Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.